



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 127 datë 22.04.2021

PËR TRANSFERIM TË PËRKOHSHËM ME PËLQIM

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 46 pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, gërma “a” të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën e transferimit të përkohshëm të prokurorit”, miratuar me Vendimin nr. 160, datë 08.07.2020 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

V E N D O S I:

1. **Z. Edmond Karriqi**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë, të transferohet përkohësisht me pëlqimin e tij, të ushtrojë funksionin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.
2. Z. Edmond Karriqi do të ushtrojë funksionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës, nga data 27.04.2021 deri më 26.10.2021.
3. Të njoftohen për këtë vendim Z. Edmond Karriqi, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI
GENT IBRAHIMI

ZV/KRYETAR
ALFRED BALLA

ANËTAR
KOSTAQ BELURI

ANËTAR
BUJAR SHESHI

ANËTAR
NURIHAN SEITI

ANËTAR
SANDËR BECI

ANËTAR
VATË STAKA

ANËTAR
TARTAR BAZAJ

ANËTAR
ELOIDA GOXHI

ANËTAR
ESMERALDA KESHI

ANËTAR
MOISI DUDA